

Sfidat e Menaxhimit të Ujrave Ndërkufitare në Rajonin e Liqeneve të Prespës

Bazuar në Workshopin me palët e Interesuara dhe Analizën Institucionale të realizuar nga Partnerët e DRIMON


Udaya Sekhar Nagothu¹, Eva Skarbøvik¹, Dusko Mukaetov², Spase Shumka³, Sonia Boglevska², Tijana Sekuloska², and Spiro Grazdhan³

¹Bioforsk, Norëay; ²Instituti per Bujqesine, Skopje, Maqedoni; ³Universiteti Bujqësor Tirane, Shqipëri.

Ky njoftim është një përmbledhje e shkurtuar e analizës institucionale dhe për palët e interesit në Liqenin e Prespës së Madhe të realizuar në kuadër të Projektit DRIMON. Qëllimi është që të ofrojë informacion për menaxherët dhe përdoruesit vendor në rajonin e Liqenit të Prespës, në lidhje me gjendjen aktuale të ekosistemit liqenor, ndikimet kryesore në të, si dhe problemet institucionale dhe të politikave në drejtim të menaxhimit të integruar të ujrave ndërkufitare. Baza e analizës është Workshopi me palët e interesit organizuar në Maj 2008 në Pretor, fshat në Komumën Resnjë në Maqedoni. Më tej informacioni është grumbullura edhe nga burime dytësore, vizita në teren dhe intervista me banorë vendas.

Një qëllim i rëndësishëm i projektit DRIMON¹ (www.drimon.no) është të kontribojë drejt të kuptuarit dhe nxitjen e dialogut midis palëve për menaxhimin e burimeve ndërkufitare në dy liqenet e Ballkanit - Prespa e Madhe dhe Shkodra. Përmes këtij informacioni, rasti i Prespës së Madhe është diskutuar duke u bazuar në informacionin dhe të dhënat e grumbulluara nga pjesëmarrësit, sidomos gjatë Workshopit të organizuar në Pretor, afër Resnjës në 30 Maj 2008.

¹ DRIMON (2006-2009) është një projekt kërkimor me emrin e plotë "Interdisciplinary assessment of water resources management in two transboundary lakes in South Eastern Europe"; mbështetur nga Norwegian Council for Research.



Liqeni Prespa e Madhe Maj 2008

Menaxhimi i qëndrueshëm i liqenit është mjaft i rëndësishëm për një seri përdoruesish që e kanë mbështetur këtu dhe egzistencën e tyre.



DRIMON, Eorkshopi 2008 Pjesëmarrësit

Projekti DRIMON shqetësohet kryesisht për ndikimet e ushqyesve në liqen. Bujqësia dhe turizmi janë identifikuar si dy nga sektorët kryesorë të këtij ndikimi.

Fakte në Liqenin e Prespës

- Ndahet përmes Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë
- Ndodhet në lartësitë më të mëdha të Liqeneve të Ballkanit, 853 m mnd
- Liqen i madh e i cekët (274 km² ; thellësia max 50 m); niveli i ujit në rënie gjatë viteve të fundit.
- Sekorët bazë te ekonomise përfshijnë bujqësinë dhe turizmin në rritje.
- Zonat e kultivuara përfshijnë 12500 ha në Maqedoni ku 3000 ha janë mbjelle me mollë; dhe 1500 ha në Shqipëri me kultura të ndryshme.
- Prespa është e pasur në larmi biologjike, me 17 lloje peshqish dhe mbi 260 lloje shpendësh, duke përfshirë koloninë e pelikanave dalmatinë.
- I shpallur si zonë Ramsar në Greqi e Maqedoni.

DRIMON Workshopi me palët e interesit
Workshopi me palët e interesuara DRIMON u organizua në Pretor më 30 Maj 2008, dhe mbledhi përfaqësues nga agjenci të ndryshme të lidhura me burimet ujore të rajonit të Prespës së Madhe. Këtu u përfshinë menaxherë, vendim marrës dhe përdorues nga sektorë të ndryshëm nga Shqipëria dhe Maqedonia.

Në workshop, pjesëmarrësit diskutuan dhe identifikuan format kryesore të presioneve, konfliktet ose problemet të lidhura me përdorimin dhe menaxhimin e Liqenit, problemet institucionale për menaxhimin ndërkufitar dhe sugjeruan nevojën e përmirësimit të menaxhimit të burimeve ujore.

Edhe pse nuk ishin të pranishëm të gjithë palët në rajon, këtu u krijua një pamje e drejtë për sfidat dhe gjendjen aktuale të menaxhimit në pjesën Shqiptare dhe Maqedonase të Liqenit. Sidoqoftë, u ra dakort që, që të rriten përpjekjet e përfshirjes në takimet e ardhshme edhe të palës Greke.



Kultura e mollës ze pjesën kryesore të prodhimit bujqësor në anën Maqedonase të Liqenit

Presione dhe ndikime në Liqenin e Prespës

Zhvillimet e shënuara në bujqësi e turizëm janë vlerësuar si positive nga pjesëmarrësit, pasi këta sektorë ofrojnë punësim për popullsinë e rajonit. Sidoqoftë, zhvillimet në këta sektorë shoqërohen edhe me ndikime negative në pellgun ujëmbledhës, duke përfshirë:


- rritja e kërkesës për ujitje dhe ujë nga sektori i turizmit, gjë që mund të ndikojë në ndryshimet e vërejtura të nivelit të ujit në liqen;

- përdorimi i papërshtatshëm i burimeve të tokës në afërsi të liqenit, ndërtimet e hoteleve e restoranteve në afërsi;
- ndotja nga ujrat e patrajtuara dhe të ndotura, penetrimet nga vendgrumbullimet e mbetjeve;
- kultivimi në afërsi të liqenit ose lumenjve pa një zonë buferike vegjetative që redukton ngarkesat dhe shpëlarjen;
- ndotja nga makinteritë e pesticidet, shpëlarja e tyre direkt në lumenj ose liqen;
- shpyllëzimet në pellgun ujëmbledhës.

DRIMON program i monitorimit të ujit

Me qëllim që të vlerësohet ndikimi i bujqësisë dhe turizmit në cilësinë e ujit, Projekti DRIMON ka ndërmarë një program për monitorimin e cilësisë së ujit. Kështu kryehet rregullisht kampionimi në lumin Golema dhe në liqen. Monitorimi fokusohet në matjen e ushqyesve dhe sedimenteve, si dhe pH, nivelet e oksigjenit dhe konduktivitetin. Ky monitorim është ndërkufitar, me kampionim në të dy anët e liqenit.

Në 2007, sasia e oksigjenit në fund të liqenit ra nën 2 mg/l gjatë stinës së verës. Kjo mbase për shkak të ushqyesve të pasuar me zhvillimin e algave në liqen. Kjo gjendje mund të çojë në gazra toksik në fund të liqenit, që mund të sjellë vdekje të peshqëve dhe formave të tjera të biotës ujore. Monitorimi vijon edhe gjatë vitit 2008 për studimin e mëtejshëm të ngarkesave me ushqyes.



Nivelet e oksigjenit në Prespë janë të reduktuara seriozisht në fundin e tij gjatë stinës së verës

Turizmi në Liqenin e Prespës

Propozimet kryesore të palëve të interesit në lidhje me uljen e ndikimeve në mjedisin

liqenor dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë

Turizmi:

- Promovimin e subvencioneve dhe kredive të buta në nivel të vogël për zhvillimin e turizmit lokal;
- Përmirësimin e eko-turizmit përmes ofrimit të formave të trajnimit për operatorët vendas, guidat, pronarët e hoteleve dhe popullisën vendase (si në rastin e shembullit në fshatin Brajchino/Komuna Resnjë);
- Zhvillimin e planeve aftagjatë për turizmin në Prespë me pjesëmarrje të palëve ndërkufitare të interesit;
- Promovimin bashkëpunimit midis operatorëve turistik dhe paketave ndërkufitare;
- Promovimin e taksës mjedisore duke parashikuar sanksionet përkatëse.



Zhvillimi i turizmit mund të sjellë çënime të habitateve (Liqeni i Prespës, Pretor Maj 2008)

Bujqësia:

- Rritja e efikasitetit të përdorimit të ujit përmes ujitjes me pika;
- Zhvillimi i Laboratorit për analizat e tokës në Resnjë duke rritur interesin në këtë drejtim; duke ndikuar në optimizimin e sasive të përdorimit të plehrave;
- Ruajtjen e sistemit aktual të stacioneve meteorologjike në Prespë dhe përmirësimin e sistemit të parashikimit për sëmundjet e bimëve dhe këshillimet për fermerët në lidhje me përdorimin përkatës të pesticideve;



Liqeni i Prespës është i njohur si vend i rëndësishëm për shpendët, me 260 lloje të ndryshme.

- Ofrimin e fidanëve të certifikuar për varietete të reja të mollëve;
- Ndërtimin e sistemeve më të mira të ruajtjes së frutave, ku fermerët do të kenë më shumë përfitime;
- Ndërtimin e kapaciteteve të reja të përpunimit parësor të frutave;
- Zbatimin e projekteve për bujqësinë organike edhe në prodhimin e mollëve.

Sidoqoftë, sfida kryesore e identifikuar nga pjesëmarrësit mbetet mungesa e burimeve financiare dhe vështirësitë për menaxhimin e integruar ndërkufitar.

Bashkëpunimi Institucional dhe ndërkufitar

Nga ana e pjesëmarrësve u shpreh fakti se këtu është e nevojshme që të promovohet menaxhimi i integruar për burimet ujore në secilin vend përpara zgjidhjes së problemeve të menaxhimit ndërkufitar.

Gjatë viteve të fundit janë vërejtur përpjekje të pakta të bashkëpunimit midis autoriteteve të ndryshme për problemet e ujrave. Një shembull të tillë përbën Këshilli Kombëtar për Ujin në Shqipëri, që është themeluar në vitin 1996 përmes Ligjit për Burimet Ujore. Këshilli drejtohet nga Kryeministri me pjesëmarrje të Ministrive të përfshira në sektorin e ujrave. Ligji parashikon krijimin në nivel vendor të këshillave për basenet ujore, por që deri tani nuk funksionojnë. Shpesh herë, nuk janë efikas mekanizmat e zbatimit në nivel vendor, dhe vendimet për sektorin e ujrave nuk shoqërohen me burimet financiare të nevojshme. Në Maqedoni, është në process ligji i ri për ujërat që duhet të ratifikohet nga qeveria, dhe që pritet të përmirësojë

bashkëpunimin në vend midis strukturave në nivele të ndryshme.



Restorante dhe hotele të reja janë duke u ndertuar në brigjet e Liqenit të Prespës (Pretor May 2008)

Sfida të ngjashme egzistojnë në rastet e bashkëpunimit ndërkufitar, ku janë organizuar mjaft takime dhe nënshkruar deklarata, por rezultatet vijuese kanë qënë të pakta.

Palën në takim vlerësuan se pak zhvillime janë vërejtur në rajon, edhe pas nënshkrimit të Dekleratës së tre Kryeministrave për Liqenin e Prespës në vitin 2000, duke e shpallur Park ndërkufitar të mbrojtur. Është sugjeruar që iniciativa lokale si shkëmbime të grupeve kulturore, takime të kryetarëve të bashkive përreth Prespës, dhe bashkëpunim shkencor ndërkufitar midis tre vendeve mund të jene te dobishme në këtë drejtim. Masë tjetër e propozuar është dhe monitorimi i përbashkët në Prespë me pjesëmarrjen e të tre vendeve dhe planifikimi i integruar nga

ana e agjensive vendore përreth Liqenit të Prespës, duke konsideruar mbështetjen përmes një marëveshjeje ndërkufitare.

E ardhmja

Një rekomandim i rëndësishëm nga ana e Workshopit DRIMONAn ishte dhe nevoja e përgatitjes së një *plani afatgjatë për zhvillimin dhe politikën* në rajonin e Prespës. Një i tillë ideal do të ishte të përgatitej së bashku nga të tre palët, nën drejtimin e strukturave të tilla si UNDP/GEF, ose alternative të pavarura nga tre vendet pjesëmarrëse.

Me qëllim që të sigurohet bashkëpunimi ndërkufitar duhet të arrihen marëveshje për disa probleme. Direktiva Kuadër për Ujin e BEsë është e dobishme në këtë kontekst, dhe Prespa mund të jetë si basen pilot për zbatimin e direktivës në të tre vendet - kjo gjë konsiderohet edhe nga ana e DRIMONit.



Forma e turizmit rural është duke u planifikuar

Projekti DRIMON (2006-2009)

Përmes integritit të shkencave natyrore dhe sociale, Projekti DRIMON do të identifikojë synimet mjedisore dhe do të ofrojë ndihmesë se si mund të arrihen këto synime, përmes të kuptuarit të strukturave institucionale përtej kufijve dhe nxitjes së dialogut ndërmjet vendim marrësve, palëve të interesuara dhe shkencëtarëve. Partnerët në Projekt janë:

- Bioforsk - Norëegian Institute for Agricultural and Environmental Research (Project leader)
- The Agricultural Institute, University of St. Cyril and Methodius, Macedonia.
- The Agricultural University of Tirana, Albania.
- Faculty of Natural Sciences and Mathematics, University of Montenegro
- NIVA, the Norëegian Institute for Water Research

Projekti është i mbështetur nga Norwegian Council for Research.

Për më tepër kërkoni: www.drimon.no